



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 588, datë 20.11.2020

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94/1 e 97/3 të Kodit të Procedurës Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarin për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në gjykatën në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Arjeta Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 110 i Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari në skemë delegimi i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkuese: {...}; Objekti: “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”.

2. Gjyqtarja në skemë delegimi e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Pavlefshmëri kontrate”.

3. Gjyqtarja në skemë delegimi e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkuese: {...}; Objekti: Përrjashtim gjyqtari.
4. Gjyqtari në skemë delegimi i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 298/3-139-25 të Kodit Penal”.
5. Gjyqtari në skemë delegimi i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 134/2 i Kodit Penal”.
6. Deklarimin të përfunduar pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës nr.1695 prot., datë 16.11.2020, të Gjykatës së Apelit Shkodër, në çështjen penale me të pandehur: {...}; Objekti: Zëvendësim mase sigurimi.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Persona nën hetim: {...}etj; Objekti: Pushim i çështjes penale nr. 676/2018 regjistruar për veprat penale të ekspertimit të rremë, shpërdorimit të detyrës dhe pengimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, parashikuar nga nenet 309, 248, 320 të Kodit Penal”.
2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Izet Salaj dhe Dritan Banushi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; Persona të kallëzuar: KKRrT Tiranë, {...}, etj; Viktima{...}; Objekti: Pushim i çështjes penale nr. 140/2018.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Asim Vokshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Dritan Banushi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78/2, 278/6, 283/2, 284/2, 333/a, 334 dhe 28/4 të Kodit Penal”.
 2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} “Nenet 259, 245/1/2, 244 të Kodit Penal”.
- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR